

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT

JAVA 14, 3 – 9 Prill 2017

Për këtë periudhë, kanë raportuar 36 rrethe ose 100% (=36/36) e tyre

3 rrethe ose 8% (=3/36) e tyre kanë raportuar me telefon, faks, postë:
HAS, M. MADHE, PEQIN,

33 rrethe ose 92% (=33/36) e tyre kanë raportuar me postë elektronike:

BERAT, BULQIZË, DELVINË, DEVOLL, DIBËR, DURRËS, ELBASAN, FIER, GJIROKASTËR, GRAMSH, KAVAJË, KOLONJË, KORÇË, KRUJË, KUÇOVË, KURBIN, LEZHË, LIBRAZHD, LUSHNJE, MALLAKASTËR, MAT, MIRDITË, PËRMET, POGRADEK, PUKË, SARANDË, SHKODËR, SKRAPAR, TEPELENË, TIRANË, TROPOJË, VLORE.

Pa raportim brenda afatit, asnjë rreth ose 0% (=0/36) e tyre:

NUMRI TOTAL I RASTEVE TË SINDROMAVE TË SURVEJANCËS "ALERT" NË JAVËN 14

	JAVA 14
DIARRE PA GJAK	1.370
DIARRE ME GJAK	0
INF. RESP. TE SIPËRME	7.566
INF. RESP. TE POSHTËME	3.958
RASH ME TEMPERATURË	6
VERDHËZA	3
HEMORRAGJI ME TEMPERATURË	0
SUSPEKT MENINGITIS	1
ETHE TË PASHPJEGUESHME	0
Numri i Njësive Raportuese	400
% e Njësive Raportuese	93% (400/427)

Rash me temperaturë

1 rast është raportuar nga rrethi i Fierit dhe 1 rast nga rrethi i Pogradecit dhe 4 raste nga rrethi i Tiranës. Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe epidemiolog të rretheve rastet nuk janë suspekt fruth apo rubeolë por varicelë.

Duke u nisur nga shpërthimet epidemike të Fruthit që po ndodhin në disa shtete të Europës dhe Ballkanit, në komunikimin me epidemiologët e rretheve është theksuar përforcimi i Survejancës së sindromit “rash makulopapular me temperaturë” nga mjekët Pediatër dhe Infeksionistë.

Verdhëza

3 rastet te grupmoshës 5-14vj, 45-59 vj dhe 60+vj janë raportuar nga rrethi i Fierit.


Më pas diagnoza u konfirmua “Leptospirozë” për një nga rastet, ndërsa dy rastet e tjera rezultuan me natyrë jo infektive.

Suspekt Meningitis


Rasti i grupmoshës 5-14vj, është raportuar nga rrethi i Fierit.
Më pas diagnoza rezultoi “Meningit bakterial”

Infeksione Respiratore

Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme sipas javëve




Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme sipas Grup-moshave




Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme paraqitet i qëndrueshëm në javën e 14 krahasuar me javën paraardhëse, java 13.

Diarre pa gjak

Trendi në kohë i Diarreve pa Gjak sipas javëve




Shpërndarja e Diarreve pa Gjak sipas Grup-moshave




Trendi në kohë i “Diarre pa gjak” paraqet ritje në javën 14 krahasuar me javën paraardhëse, java 13.

Trendi i “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 01 – 14 të vitit 2016 dhe të vitit 2017 . Numri i rasteve.




Në javën e 14-të të vitit 2017 vërehet një trend i qëndrueshëm i numrit të infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme dhe ky numër është 11% më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.


Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas grupmoshës në javën e 14-të të vitit 2017. Numri i rasteve dhe Incidenca (raste/10.000)




Krahasimi i aktivitetit të “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas sezoneve (javët 40 – 20) dhe Pragu Epidemik. Raste/100.000




Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas rretheve në javën 13 dhe 14 të vitit 2017. Incidenca (raste/10.000)



Trendi i “Diarreve pa Gjak” në javët 01 – 14 të vitit 2016 dhe të vitit 2017. Numri i rasteve.

Në javën e 14-të të vitit 2017 vërehet një trend në ritje i numrit të rasteve të “Diarre pa gjak” dhe ky numër është 22% më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas rretheve në javën 13 dhe javën 14 të vitit 2017. Incidenca (raste/10.000)

Shumica e rasteve janë raportuar nga Urgjenca e Spitaleve dhe janë të shpërndara, pa grumbullime dhe lidhje epidemiologjike ndërmjet tyre.

Nivelet e Raportimit për javën e 14 sipas rretheve, në përqindje.

